

## Kërkesë për fitim shtetësie për të huajt të martuar me një shtetas shqiptar

### 1. Baza Ligjore:

- a. Ligji nr. 8389, date 05.08.1998 “Per shtetesine shqiptare” i ndryshuar;
- b. Udhezimin e perbashket i Ministrit te Rendit Publik (nr. 925 date 03.03.1999), Ministrit te Puneve te Jashtme (nr.337/1 date 08.03.1999) , Ministrit te Drejtesise (nr.782/1 date 25.03.1999) dhe Ministrit te Financave (nr.583/3 date 05.03.1999) “Per procedurat qe ndiqen per fitimin e shtetesisë shqiptare me natyralizim”;
- c. Udhezimin e Ministrit te Rendit Publik (Nr. 3583 date 27.11.2001) dhe Ministrit te Puneve te Jashtme (nr. 6252 date 10.12.2001) “Per procedurat dhe dokumentacionin per fitimin, rifitimin dhe heqjen dore nga shtetesia shqiptare”.

### 2. Kriteret thelbësore dhe dokumentet shoqërues

Kriteret thelbësore	Dokumentet Shoqëruese (provuese dhe të tjera shoqëruese)
1. Të ketë mbushur moshën 18 vjeç në ditën e bërjes së kërkesës	Kopje të dokumentit të identifikimit
2. Të ketë banuar ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të vazhdueshme, por jo më pak se 1 vitë, brenda periudhës së martesës.	Kopje të lejes së qëndrimit
3. Të ketë siguruar kushte banimi dhe të disponojë të ardhura të mjaftueshme	Akti i pronësisë së banesës ose kontrata e zënies me qera të banesës  &  Kontratë pune për të punësuarit ose vërtetim nga Zyra e tatimeve për të vetpunësuarit ose investitorët (fotokopje e noteruar)  Dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë si garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash.
4. Të mos ketë qenë ndonjëherë i dënuar (në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë vend tjetër) për vepra penale, për të cilat ligji parashikon denime me jo më pak se 3 vjet heqje lirie. Perjashtim nga ky rregull behen ne rastet kur vleresohet se denimi eshte dhene per motive politike.	Deshmi penaliteti e marre ne vendin e origjines dhe ne vendin ku kerkuesi ka patur qendrim legal per gjashte muajt e fundit (vetëm në origjinal) dhe sipas rregullave për njohjen e dokumentave të shteteve të huaja nëse është leshuar nga një shtet tjetër.  &  Formular Vetedeklarimit

5. Dhenia e shtetesise shqiptare te mos preke sigurimin dhe mbrojtjen e Republikes se Shqiperise	
6. Të jetë i martuar me një shtetas Shqiptar	Certifikata e martesës (vetëm në origjinal) dhe sipas rregullave për njohjen e dokumentave të shteteve të huaja nëse është lëshuar nga një shtet tjetër
	Kërkesa e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës. Kërkesa të përmbajë identitetin e plotë të kerkuesit (emër mbiemër, datëlindje, vendlindje, shtetësi), adresën e saktë të vendbanimit të tij të përherëshëm dhe adresën ku pret informim për ecurinë e aplikimit të tij, arsyet e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare. Kërkesa nënshkruhet me emër mbiemër e firmë nga kerkuesi;
	Çertifikata e lindjes dhe certifikate familjare (vetëm në origjinal) dhe sipas rregullave për njohjen e dokumentave të shteteve të huaja nëse është lëshuar nga një shtet tjetër
	Çertifikata e lindjes (vetëm në origjinal) e bashkëshortit/bashkëshortes shqiptare.
	Fotografi e aplikantit, cope tre (Në rast se ka femijë nën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre).

### 3. Procedura/Njesite pergjegjese/afatet e ndermjetme

- a. Kërkesa mund të paraqitet në ZSHQ apo për shtetasit e huaj, që banojnë jashtë shtetit aplikimi mund të bëhet edhe në përfaqësinë diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetin ku ai është rezident ose në përfaqësinë që mbulon shërbimet konsullore për vendin ku ai është rezident.
- b. Kërkesa së bashku me praktikën dërgohet, nga ZSHQ në sekretari, e cila ja kalon seksionit përkatës, ku ky i fundit plotëson praktikën me ndihmën e Njësive përgjegjëse të ndërmjetme dhe e dërgon për në Drejtorinë Vendore të Policisë.
- c. Njësia përgjegjëse e ndërmjetme është **Seksioni për Krimet, Seksioni i Shërbimeve ndaj të tretëve** (në të njëjtin Komisiariat), si dhe kartoteka kriminale dhe dëshmia e penalitetit:

- i. seksioni i policisë kriminale harton raportin për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë; Raporti nënshkruhet nga shefi i komisariatit të policisë; Ky raport i bashkëlidhet praktikës brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës .
  - ii. Ndihmes specialisti i zbatim vendimeve dhe i kontrollit të armeve kërkon Dëshminë e Penalitetit nga specialisti përgjegjës, e cila brenda 15 ditëve duhet të kthej përgjigje dhe do ti bashkëlidhet praktikës përpara dërgimit në Drejtorinë Vendore të Policisë.
  - iii. Së bashku me kërkesën, në Drejtorinë Vendore të Policisë dërgohet edhe Raportimi për nivelin e njohurive të gjuhës shqipe i hartuar nga nëpuënsi i ZSHQ pranues i aplikimit, i cili përpilohet në momentin e aplikimit dhe i bashkëlidhet praktikës.
  - iv. E gjithë praktika duhet të dërgohet në sektorin e rendit pranë Drejtorisë Vendore të Policisë brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës.
- d. Seksioni përkatës në drejtorinë Vendore të policisë :
- i. Specialisti i drejtimit përkatës në drejtorinë e policisë vendore kryen këto procedura:
    - a. Verifikon dhe kontrollon përputhshmërinë e praktikës sipas kërkesave ligjore.
    - b. Mbas kompletimit të plotë të praktikës ja kalon për shqyrtim të mëtejshëm strukturës përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme, e cila nuk duhet ti kaloj 30 ditë nga paraqitja e kërkesës në ZSHQ, në rast se konstaton mangësi komunikon me ZSHQ për kompletimin e plotë të praktikës.
  - e. Njësia përgjegjëse përfundimtare është **Ministria e Punëve të Brendshme**. Vendimi për paraqitjen ose jo të kërkesës te Presidenti i Republikës i njoftohet ZSHQ, brenda 6 muajve nga paraqitja e aplikimit.

**4. Afati i Përgjithshëm i Procedurës (për njoftimin e kërkesit):** 6 muaj.

**5. Afati i Vlefshmërisë së licencës:** nuk zbatohet

**6. Tarifa e procedures:** 6 000 lekë

**7. Taksa e veprimtarise:** nuk zbatohet